

VENDIM
Nr. 399, datë 20.6.2012

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT,
DATË 15.3.2012, PËR ÇËSHTJEN NR. 10810/05 “ÇAUSH DRIZA KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, si dhe të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.3.2012, për çështjen nr. 10810/05 “Çaush Driza kundër Shqipërisë”, për kompensimin fizik të pronës me sipërfaqe 360 (treqind e gjashtëdhjetë) m².

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

3. Autorizohet Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për kompensimin fizik të pronës, me sipërfaqe 360 (treqind e gjashtëdhjetë) m², në favor të z. Çaush Driza.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha